



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:130691

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05858776

Ac.nr.5868/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Naime Ahmeti e Halide Reka anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike të paditësit A. Z nga Komuna Istog, të cilin e përfaqëson F. K avokat në Pejë, kundër të paditurës Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim të kualifikimit pa shkëputje nga puna, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.325/2021 të datës 13.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.325/2021 i datës 13.07.2022, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. Z nga Istogu, ashtu që detyrohet e paditura Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguajë paditësit, në emër të kompensimit 35% të pagës mbi bazë të kualifikimit për periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 e deri më 31.12.2020 apo për 44 muaj pune (për secilën muaj të pranisë në punë shumën nga 78.10 €), shumën e përgjithshme prej 3,436.66 €, me kamat ligjore prej 8 % nga data 11.05.2021 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditorë nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II., të dispozitivit obligohet e paditura Komuna e Istogut-Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, të prishet aktgjykimi i atakuar dhe të hedhet poshtë padia.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi A. Z ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Istogut-Drejtoria Komunale e Arsimit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia paguajë paditësit, në emër të kompensimit 35% të pagës mbi bazë të kualifikimit për periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 e deri më 31.12.2020 apo për 44 muaj pune (për secilën muaj të pranisë në punë shumën nga 78.10 €), shumën e përgjithshme prej 3,436.66 €, me kamat ligjore prej 8 %.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, nga aktvendimi mbi licencim dhe licenca me nr. 100019277 e dt. 13.12.2013, si dhe nga diploma e lëshuar me dt.21.01.2019 nga Kolegji "...” Qendra në Prishtinë me dt.28.09.2018 ka fituar titullin e Master i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Lidhur me ekzistimin e shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore, Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte i përfshirë as me shkeljet e pretenduara e as me shkelje esenciale neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar, kolegji i Gjykatës së Apelit gjenë se, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi A. Z ka fituar titullin Master i Shkencave Kompjuterike dhe

Inxhinieri dhe se është i pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka gjetur se e paditura nuk i ka bërë pagesat paditësit lidhur me licencimin.

Lidhur me aplikimin e të drejtës materiale, Gjykata e Apelit gjen se e drejta e paditësit për pagesat lidhur me licencimin buron nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008 i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.20023. Ndonëse paditësi në parashtrimet e tij, është thirrur në Kontratën Kolektive të Arsimit Para universitar është përcaktuar se: *“Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë : Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës Bazë”,* kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se në nenin 2.2 të LPK-së, është parashikuar që: *“Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”. Sipas nenit 2.2 kualifikimin juridik të kërkesës e bën gjykata, sepse vlen parimi fundamental **da mihi facta, dabo tibi ius [më jep faktin të jap të drejtën].***

Meqenëse baza juridike e kërkesëpadisë apo baza për kompensim për tu trajtuar kërkesat e tilla gjendet në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008 dhe çështja e kompensimit të mësim dhënësve mbi bazën e kualifikimit (licencimit) duhet të trajtohet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me vendimin e qeverisë, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me 06.02.2023¹, kolegji gjen se meqë nuk krijohet ndonjë gjendje tjetër juridike, për të vendosur ndryshe nga sa është vendosur në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në një gjendje të tillë të çështjes, kolegji i Gjykatës së Apelit ka vendosur që pretendimet ankimore edhe sa i përket të drejtës materiale të refuzohen si të pa bazuara dhe që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5868/2022, me datë 18.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj

¹ Shih Mendimi Juridik i Gjyktës Supreme GJ.A.Su.A 214/2023, i datës 05.10.2023.